



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

SYLLABUSI I LËNDES: FINANCAT E AVANCUARA NDËRKOMBËTARE

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Financat e Avancuara Ndërkombetare
Niveli:	Doktoratë
Status i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	45 h
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Semestri dimëror
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Lënda " Financat e Avancuara Ndërkombetare " në programin e doktoratës në Biznes dhe Ekonomi ka për qëllim t'u ofrojë studentëve të doktoraturës një kuptim të thellë dhe kritik mbi konceptet, teoritë dhe praktikën e avancuara në fushën e financave ndërkombëtare. Lënda fokusohet në analizën komplekse të tregjeve financiare globale, menaxhimin e rrezikut financiar ndërkombëtar, strategjitë e investimeve ndërkombëtare, dhe ndikimin e politikave makroekonomike në vendimet financiare të korporatave shumëkombëshe.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimet kryesore të lëndës "Financat e Avancuara Ndërkombetare" janë: 1. <i>Pajisja me aftësi të avancuara në fushën e financave:</i> T'u ofrojë studentëve një kuptim të avancuar strategjitë për strukturimin e financimit ndërkufitar dhe optimizimin e strukturës së kapitalit në korporatat shumëkombëshe. 2. <i>Zhvillimi i aftësive kërkimore:</i> Të nxisë aftësitë analitike dhe kërkimore përmes analizës së literaturës shkencore dhe aplikimit të metodave të kërkimit empirik në studimet e financave ndërkombëtare. 3. <i>Promovimi i Mendimit Kritik dhe Inovativ:</i> Të inkurajojë zhvillimin e mendimit kritik dhe inovativ për të adresuar sfida komplekse në financat ndërkombëtare, duke përfshirë çështjet e qëndrueshmërisë dhe investimeve të përgjegjshme. 4. <i>Aftësimi për Menaxhimin e Rrezikut Ndërkombëtar:</i> Të

	pajisë studentët me njohuri për identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve që lidhen me investimet ndërkombëtare, duke përfshirë rrezikun e kursit të këmbimit, rrezikun e normës së interesit dhe rreziqet politike.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi, studenti është në gjendje të: • Zotëron kuptimin e thellë të financave të avancuara ndërkombëtare, ku përmes këtyre njohurive të arrijë që të kontriboj në Ekonomi. • Zhvillon plane gjithëpërfshirëse të zhvillimit finaciar duke përdorur njohuri të avancuara teorike dhe empirike për të adresuar nevojat dhe mundësitë specifike të tregut. • Studenti do të jetë në gjendje të analizojë dhe të zbatojë teoritë kryesore të financave ndërkombëtare, përfshirë teoritë e kursit të këmbimit, paritetin e fuqisë blerëse dhe paritetin e normave të interesit. • Kryen kërkime dhe analiza të avancuara empirike, duke vlerësuar politikat aktuale ekonomike. • Demonstronë aftësinë për të analizuar dinamikat e tregjeve financiare globale dhe të vlerësojnë ndikimin e faktorëve makroekonomikë dhe politikave ndërkombëtare në këto tregje. • Kryen analiza të avancuara të tregut duke identifikuar trendet, strategjitë dhe mundësit për zhvillimin e politikave adekuate. • Zbaton software bashkëkohorë për analizën e të dhënave cilësore dhe sasiore që ndërlidhen me financat, duke përfshirë SPSS, dhe STATA, në projektet kërkimore. • Studenti duhet të jenë në gjendje të marrë vendime strategjike në lidhje me investimet ndërkombëtare, duke përdorur analiza të thella financiare dhe vlerësimin e projekteve globale. • Inicion dhe koordinon projekte bashkëpunuese me aktorë lokalë, bizneset ndërkombëtare dhe institucionet qeveritare për të adresuar sfidat financiare dhe ekonomike globale, si dhe për të promovuar zhvillimin ekonomik gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm. • Zbaton metodologji bashkëkohore dhe inovative të mësimdhënies që transformojnë përvojën e të nxënit, duke inkurajuar mendimin kritik dhe zbatimin praktik të teorive të financave ndërkombëtare në kontekste reale të biznesit dhe ekonomisë globale.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej

Ligjerata	3	9	27
Leximi i literaturës shkencore	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	9	18
Rastet e studimit dhe grupet e diskutimit	2	5	10
Përgatitja për provimin final	4	5	20
Hulumtimi dhe mbledhja e të dhënave	3	5	15
Analiza e të dhënave dhe hartimi i punimit hulumtues	5	5	25
Rishikimi/kontrollimi i punimit dhe përgaditja për prezentim	1	5	5
Totali			150

Metodologjia e mësimdhënies:

Metodologjia e mësimdhënies për lëndën "Financat e Avancuara Ndërkombetare" në programin e doktoratës në Biznes dhe Ekonomi përdor një metodologji të integruar mësimdhënieje që kombinon teori dhe praktikë për të ofruar një përvojë të pasur dhe gjithëpërfshirëse të të nxënit.

1. *Ligjerata interaktive*: Ligjëratat ofrohen në mënyrë interaktive për të inkurajuar diskutimin dhe mendimin kritik mbi konceptet kryesore dhe teoritë e avancuara të financave ndërkombëtare. Studentët inkurajohen të kontribuojnë aktivisht me pyetje dhe shembuj nga përvoja e tyre.

2. *Rastet e studimeve dhe workshop-e*: Përdoren raste nga praktika reale për të analizuar sfidat dhe vendimet financiare të korporatave shumëkombëshe. Këto studime ndihmojnë studentët të aplikojnë teoritë e mësuara në situata konkrete, duke nxitur aftësi për zgjidhjen e problemeve.

3. *Prezantime individuale dhe grupore*: Studentët angazhohen në projekte kërkimore të pavarura ose grupore, ku përdorin metodologji të avancuara analitike dhe kuantitative për të adresuar çështje komplekse financiare. Rezultatet prezantohen për të zhvilluar aftësitë e komunikimit akademik dhe

	profesional. Kjo metodologji synon të zhvillojë aftësitë analitike, kërkimore dhe strategjike të studentëve, duke i përgatitur ata për sfidat e financave në një kontekst global.
Metodat e vlerësimit:	• Projekti Kërkimor: 30% • Provimi Final: 60% • Pjesëmarrja dhe Diskutimet: 10% Në total, nota përfundimtare do të përbëhet nga këto tre elemente kryesore, duke vlerësuar angazhimin dhe aftësitë e studentit në secilën prej tyre.
Literatura	
Literatura bazë:	▪ Jeff Madura (2018) – <i>International Financial Management</i>, 13th Edition, Pearson. ▪ David K. Eiteman, Arthur I. Stonehill, Michael H. Moffett (2020) – <i>Multinational Business Finance</i>, 15th Edition, Pearson. ▪ Paul R. Krugman, Maurice Obstfeld (2017) – <i>International Economics: Theory and Policy</i>, 10th Edition, Pearson. ▪ Kirt C. Butler (2005) – <i>Multinational Finance: Evaluating Opportunities, Costs, and Risks of Operations</i>, Pearson Prentice Hall. ▪
Literatura shtesë:	▪ Ronald MacDonald (2007) – <i>Exchange Rate Dynamics</i>, Wiley-Blackwell. ▪ John C. Hull (2015) – <i>Risk Management and Financial Institutions</i>, 4th Edition, Pearson. ▪ Maurice D. Levi (2014) – <i>International Finance: The Markets and Financial Management of Multinational Business</i>, 8th Edition, Routledge. ▪ Artikuj akademikë nga revista si <i>Journal of International Money and Finance</i> dhe <i>Journal of Financial Economics</i>. ▪ Raporte nga institucione si Banka Botërore, FMN, dhe OECD

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Sesioni i parë:	Hyrje (Prezantimi i lëndës, metodat e punës dhe vlerësimit) Parimet e menaxhimit financiar multinacional dhe mjedisi ndërkombëtar <i>Diskutimi mbi parimet dhe sfidat e menaxhimit të financave në një kontekst ndërkombëtar. Roli i globalizimit në menaxhimin financiar dhe zhvillimin e korporatave shumëkombëshe</i>
Sesioni i dytë:	Tregjet ndërkombëtare të kapitalit dhe lëvizja e fondeve <i>Analizë e tregjeve financiare globale dhe fluksit ndërkombëtar të fondeve</i> Roli i tregjeve ndërkombëtare të valutave <i>Karakteristikat dhe funksionimi i tregjeve valutore globale</i>
Sesioni i tretë:	Teoritë e përcaktimit të kursit të këmbimit <i>Diskutimi mbi teoritë kryesore dhe faktorët që ndikojnë në kursin e këmbimit</i> Parashikimi i kursit të këmbimit dhe modelet e parashikimit <i>Metodat për parashikimin e kursit të këmbimit dhe aplikimi i modeleve të ndryshme</i>
Sesioni i katërt:	Menaxhimi i rrezikut transaksional dhe ekonomik <i>Strategjitë për mbrojtjen ndaj rreziqeve të kursit të këmbimit</i> Instrumentet derivative për menaxhimin e rrezikut <i>Përdorimi i opsioneve dhe kontratave future për mbrojtjen ndaj rrezikut të këmbimit.</i>
Sesioni i pestë:	Pariteti i normës së interesit dhe arbitrimi <i>Analizë e marrëdhënieve midis normave të interesit dhe mundësive të arbitrit</i> Pariteti i fuqisë blerëse dhe inflacioni <i>Studimi i marrëdhënieve ndërmjet inflacionit dhe kurseve të këmbimit.</i>
Sesioni i gjashtë:	Investimet e huaja direkte (FDI) <i>Faktorët që ndikojnë në vendimet për investime dhe kthimi nga këto investime</i> Struktura e kapitalit multinacional <i>Vendimmarrja për strukturën e kapitalit dhe financimin e aktiviteteve ndërkombëtare</i>

Sesioni i shtatë:	Financimi ndërkombëtar i tregtisë dhe menaxhimi i detyrimeve afatshkurtra <i>Strategjitë për financimin e tregtisë dhe administrimin e likuiditetit ndërkombëtar</i> Menaxhimi i kapitalit punues ndërkombëtar <i>Menaxhimi efektiv i kapitalit punues për korporatat multinationale</i>
Sesioni i tetë:	Prezentimi i punimeve hulumtuese
Sesioni i nëntë:	Prezentimi i punimeve hulumtues

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
Cakto politikat e mirësjelljes konform statusit të UHZ-së. • Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore; • Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore; • Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit dhe mjetit të identifikimit në teste dhe provim; • Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet të përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësuesi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit; • Testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student. Prandaj, studentet duhet të përqëndrohen vetëm në njohuritë personale. • Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet konform normave të parapara me ligj.	